



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 21/2 Prot.

Tiranë, më 20/12/2010

URDHËR

Nr. 21/2, datë 20/12/2010

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit mbi kontrollin administrativ të ushtruar pranë kontrolluesit **Eagle Mobile sh.a.**

KONSTATOVA

Nga data 18.10.2010 deri 03.11.2010 grupi i inspektimit i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer kontrollin administrativ pranë kontrolluesit, **Eagle Mobile sh.a.**, si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Zbatimi i kushteve dhe kritereve të parashikuara në nenet 5,6,7,8, të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.
- Siguria e të dhënave personale, masat për sigurinë e të dhënave personale.
- Njoftimi i të dhënave që përpunohen.
- Si zbatohen rregullat e konfidencialitetit për përpunimin e të dhënave personale.
- Si evidentohen dhe zbatohen Udhëzimet e Vendimet e Komisionerit.
- Kategoria e mjeteve të përpunimit që përdoren konformë kushteve dhe kritereve të dispozitave të mësipërme.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi materialet e kontrollit administrativ, (procesverbalin e konstatimit të shkeljeve, relacionin etj..) si dhe provat e administruara vëren se:

1. Kontrolluesi Eagle Mobile sh.a gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij kryen transferim ndërkombëtar të të dhënave personale drejt një shteti që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, pasi realizon printimin e faturave **“për shpenzime telefonike të klientëve”**, (*të cilat mbartin të dhëna personale si: emër, mbiemër, numër telefoni, adresë, numrat e thirrur etj*), nëpërmjet kompanisë turke “Hobin Bilgi Islem Hizmetleri A.S” me vëndodhje në Turqi. (Turqia nuk përfshihet në VKM nr. 934 datë 2.09.2009 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”). Ky kontrollues nuk ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pajisjen me **autorizim për transferim ndërkombëtar** të të dhënave personale të pajtimtarëve, drejt një shteti që nuk ka nivel të mjaftueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

- Në këtë rast është shkelur neni 9 pikat 1 dhe 4 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” ... *pika 1 “Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, në raste të tjera nga ato të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, bëhet me autorizim të komisionerit”...pika 4... “Kontrolluesi, përpara transferimit të të dhënave, bën kërkesë për autorizim te Komisioneri. Në kërkesë kontrolluesi duhet të garantojë respektimin e interesave për ruajtjen e sekretit të subjektit të të dhënave jashtë Republikës së Shqipërisë”*

2. Kontrolluesi Eagle Mobile sh.a nuk ka të shprehur në kontratë e lidhur me pajtimtarët, informimin e tyre (marrjen e pëlqimit specifik) për transferimin ndërkombëtar.

- Nuk është zbatuar neni 18 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. *“Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet ta informojë subjektin e këtyre të dhënave. Në këtë informacion duhet të përcaktohen kategoritë e të dhënave personale, që do të përpunohen, qëllimi i përpunimit, emri dhe adresa e kontrolluesit dhe çdo informacion tjetër, i nevojshëm, për të garantuar përpunimin e drejtë të të dhënave personale. Ky informacion nuk jepet, nëse subjekti i të dhënave ka dijeni për të”.*

3. Kontrolluesi Eagle Mobile sh.a nuk ka deklaruar transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale të pajtimtarëve në formularin e njoftimit të dorëzuar pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- Në këtë rast është shkelur neni 21 pika 1 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 ...“Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

URDHËROJ:

1. **Pezullimin e transferimit ndërkombëtar të te dhënave personale të pajtimtarëve të tij drejt shtetit të Turqisë, deri në pajisjen me autorizim nga ana e Komisionerit Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në zbatim të nenit 9 pika 1 e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”**
2. **Informimin dhe marrjen e pëlqimit specifik të pajtimtarëve, për transferimin ndërkombëtar të te dhënave personale të tyre, duke e shprehur këtë qartë në kontratën e lidhur me pajtimtarët në zbatim të neneve 8 dhe 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”**
3. **Plotësimin menjëherë të njoftimit pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke deklaruar transferimin ndërkombëtar të te dhënave personale drejt shtetit të Turqisë, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.**

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

